


Bashkia Librazhd



Raporti Performancës 2020



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2020 të Bashkisë Librazhd.

https://public.tableau.com/vieës/Librazhd-RaportiInteraktiv2020/Tedhenatadministrative?:language=en&:displaycount=y&:origin=viz_share_link

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Librazhd me asistencën e Projektit Bashki të Forta dhe Kompania e konsulencës Shapo Consulting.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues	3
Të dhëna të përgjithshme	5
Burimet e Financimit	6
Shpenzimet buxhetore	7
Investimet	8
Treguesit Financiar	9
Administrimi i bashkisë	10
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	12
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	14
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	15
Rrjeti rrugor rural	17
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	19
Shërbime publike vendore	22

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mbliidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport





Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshembull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

Treguesit kyç financiarë – llogaritja dhe domethënia e tyre:

- **Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave.** Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave. Me pak ndryshime raporti tregon sesa shpenzon bashkia për të ofruar një Lek shërbime publike.


- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara nga viti i kaluar. Një raport i lartë është pozitiv për bashkinë pasi tregon se ajo nuk mbështetet në burime të jashtëme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.).
- **Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon kapacitetin fiskal të bashkisë. Një normë e lartë mund të sygjerojë jo vetëm mbledhjen e mirë të detyrimeve fiskale por edhe taksa apo tarifa të larta.
- **Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifave vendore ndaj planit të tyre.** Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë bëhet e përhershme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.
- **Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore.
- **Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve.** Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- **Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave.** Huaja afatgjatë i referohet një periudhe më të madhe sesa një vit. Një normë e ulët tregon se bashkia është e aftë t'a paguajë borxhin sipas afatit të caktuar. Një normë e lartë mund të sygjerojë se bashkisë do t'i duhet të ulë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë që të shlyejë borxhin.
- **Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave.** Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.
- **Norma e shpenzimeve për politikave sociale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim		Përkeqësim	
E njëjta situatë		Nuk ka informacion	

Të dhëna të përgjithshme

Bashkia Librazhd



Bashkia Librazhd e pozicionuar në lindje të vendit përbëhet nga 7 Njësi Administrative: Steblevë, Lunik, Orenjë, Qendër, Librazhd, Hotolisht dhe Polis me sipërfaqe prej 793.36 km². Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit. Popullsia e bashkisë numëron 31,892 banorë (sipas të dhënave të Censurit) me një përfaqësim gjinor 50.2% femra dhe 49.8% meshkuj. Bashkia ka një numër total familjesh prej 17,186 nga të cilat 27% në pjesën urbane dhe 73% në pjesën rurale të bashkisë. Rrjeti rrugor prej 932.42 km linear shtrihet në rreth 153.2 km në pjesën urbane të saj. Gjatë vitit 2020 u shënuan 828 lindje dhe 670 vdekje duke pasur një raport pozitiv të rritjes së popullatës për gjithë bashkinë.


Bashkia drejtohet në mandatin e parë të dytë nga Kryetari **Kastriot Gurra**, gjatë zgjedhjeve të fundit vendore morën pjesë rreth 37,60 % e zgjedhësve.

Viti 2020 shënoi një vit të vështirë për ekonominë e bashkisë dhe shëndetin e popullatës për shkak të situatës Pandemike që është prezente tashmë në mbarë botën. Bashkia u mundua t'i qëndrojë pranë komunitetit sidomos shtresave në nevojë si edhe duke lehtësuar barrën fiskale të biznesit të vogël.

Është për t'u theksuar se gjatë këtij viti bashkia i ka ardhur në ndihmë familieve në nevojë të prekura më së shumti nga situata e vështirë pandemike.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (000 Lekë)		FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
		1,643,717	1,332,009	1,396,473	1,422,563	93%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Fakt Vs Plan 2020 në %
TË ARDHURA E VETA	Të ardhura nga tarifa vendore	59,377	100,743	71,382	94,451	75.58%
	Të ardhura nga taksat lokale	23,332	32,420	32,451	34,050	95.30%
	Të ardhura nga taksat e ndara	6,936	8,635	9,865	10,865	90.80%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	895,968	627,772	740,228	740,000	100.03%
	Transferta e pakushtëzuar	268,865	281,913	273,492	273,492	100.00%
	Trasferta specifike	131,075	134,346	134,991	134,991	100.00%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi pa destinacion	148,711	119,704	66,140	66,140	100.00%
	Trashëgimi me destinacion	91,642	22,876	22,195	22,195	100.00%



Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet në mbi 80% nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit luhaten në kufijtë 7 - 11% të të gjitha të ardhurave të bashkisë. Edhe pse një vit jashtëzakonisht i vështirë 2020 shënoi një rritje të kontributit të burimeve të veta të financimit kundrejt vitit 2019 duke reflektuar kështu ndryshimin që vjen prej rritjes së kontribut të QQ kryesisht për projekte investimesh në këtë bashki, kështu:

- Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë u rritën me 5% kundrejt vitit 2019 ku ato nga taksat, dhe tarifat lokale u rritën me 10%;
- Totali i burimeve të financimit të bashkisë u realizua në masën 98% kundrejt planit për vitin 2020.

Shpenzimet buxhetore

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT (000 Lekë)	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI NË %
		1,643,717	1,332,010	1,269,913	1,427,714
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe m...	276,090	6,967	329,712	333,885	98.75%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	244,256	492,891	272,601	276,264	98.67%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	197,453	202,225	177,796	205,461	86.54%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	113,623	153,357	163,128	180,890	90.18%
Rrjeti rrugor rural	331,226	115,076	94,256	147,319	63.98%
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe ..	44,010	45,771	52,265	63,535	82.26%
Shërbime publike vendore	70,148	36,320	39,416	50,627	77.86%
Furnizimi me ujë	169,470	34,607	23,072	26,746	86.26%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	22,429	20,086	14,756	18,071	81.66%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	23,294	37,990	14,497	28,974	50.03%
Sport dhe argëtim	81,498	59,014	12,685	12,685	100.00%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	26,231	43,787	9,128	9,658	94.51%
Gjendja civile	7,601	5,120	7,068	7,276	97.14%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike d..	18,155	13,366	6,937	9,086	76.35%
Shërbimet e Policisë Vendore	0	4,819	5,147	5,343	96.33%
Menaxhimi i mbetjeve	1,736	27,236	1,677	3,694	45.40%
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	1,588	1,621	1,562	1,629	95.89%
Garanci	0	0	0	0	0.00%
Totali fondi rezerve + kontigjence	0	0	0	0	1 null


Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2020 shënuan rënie kundrejt vitit 2019 me rreth 5%, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2020 ishte rreth 89%. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- *Kujdesi social për PAK*
- *Kujdesi social për familje dhe fëmijë*
- *Administrimi i bashkisë*
- *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin*
- *Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit*
- *Rrjeti rrugor rural*
- *Shërbime publike vendore*

Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (000 Lekë)	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
	180,143	148,410	284,790	369,449	77%



Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 285 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2019 investimet janë ulur me rreth 27% kjo shpjegon uljen e kontributit të tyre në buxhet nga 29% në fund të vitit 2019 në vetëm 22% në fund të vitit 2020. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2020 kundrejt planit është në masën 77%. Investimet e bashkisë gjatë vitit 2020 kanë treguar se:

- Investimet zënë në fund të vitit 2020 rreth 16% të buxhetit të bashkisë nga 24% në vitin 2019
- Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: infrastrukturës rrugore, furnizimin me ujë të pijshëm, përmirësim i ndërtesave në institucionet arsimore (mesëm dhe bazë); sistemin e vaditjes dhe kullimit, përmirësim i lagjeve të brendshme dhe kënde lojrash për fëmijë etj.

Treguesit Financiar

Treguesit Financiarë të shprehur në %	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	TRENDI I PERFORMANCËS
Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave	3.9%	1.4%	0.0%	2.3%	↑
Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve	36.0%	29.4%	22.4%	24.8%	↓
Norma e shpenzimeve korente ndaj totalit të shpenzimeve	64.0%	70.6%	77.6%	75.2%	↓
Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	32.6%	40.2%	42.1%	51.2%	↑
Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave	6.5%	10.9%	11.9%	14.3%	↑
Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj totalit të të ardhurave	5.5%	10.6%	10.8%	13.3%	↑
Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave	100.0%	100.0%	97.4%	100.0%	↓

Dy fjalë mbi treguesit kyç financiarë

Treguesit kyç financiarë japin një pamje të menaxhimit financiar të fondeve publike të bashkisë. Përtej tendencave vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkisë, këto tregues synojnë të japin informacion mbi qëndrueshmërinë financiare dhe performancën reale të bashkisë.


Përgjatë vitit 2020 financat e bashkisë karakterizuar nga:

- Ulja e detyrimeve të prapambetura duke përmirësuar kështu edhe marrëdhëniet kontraktuale të bashkisë me të tretët
- Rritja e peshës së të ardhurave të veta të bashkisë në tërësinë e burimeve të financimit të buxhetit të saj
- Rritja e mbështetjes së shërbimeve sociale në tërësi
- Ulja e peshës së investimeve dhe rënia e peshës së shpenzimeve korente (për mirëmbajtje, paga; etj) në tërësinë e buxhetit të bashkisë
- Ekzekutimi i buxhetit ka hapësira për përmirësim pasi masa e shpenzimeve nuk është tërësisht në kapacitetet e fondeve të disponueshmërisë së bashkisë.

Administrimi i bashkisë

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
		14%	87%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin.

Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korrente dhe investim

Tren di	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)		64.7		-85.7
	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	5.3	1.0		
	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	5.3	2.5		2.3

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Ditë trajnimi në total	201	68		70
Numri total i personave të trajnuar	38	27		30

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë (në mijë Lekë)	84,391	76,781	79,657	75,451
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	17	28		4
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	21	4		0
Numri total i punonjësve të bashkisë	397	397	350	397

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 87% të planit 2020. Bashkia shpenzon rreth 14% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2020 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2020 tregon se:

- Është përmirësuar respektimit i kuadrit ligjor dhe rregulloret e administratës. Nuk janë aplikuar masa disiplinore për punonjësit e bashkisë;
- Janë rritur kapacitetet profesionale të administratës.
- Është rritur qëndrueshmëria e administratës.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Administrimi i bashkisë	31,420	59,727	41,783	48,221	87%
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje kondicioner			347	347	100%
Studime projektive			120	120	100%

Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

Realizimi	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
-----------	--------------------	-------------------------	-----------------------


faktik 2020



26%

99%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i kushteve të jetesës së personave të sëmurë dhe me aftësi të kufizuara. Rritja ose përmirësimi i skema / institucioneve që ofrojnë shërbime për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
→	Numri shërbimeve të ofruara për persona PAK në shtëpi (Ndryshimi vjetor në %)		0	0	1
○	Perfitimi monetar (në mijë lekë) për persona të sëmurë dhe PAK	100	3		1
↑	Persona me aftësi të kufizuara të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale (Ndryshimi vjetor në %)	0	0		13
○	Persona të mbështetur me pagesë invaliditeti (Ndryshimi vjetor në numer)		-56		50
○	Shpenzimet totale në qendrat e shërbimeve PAK kundrejt numrit total të personave të akomoduar në këto qendra (Mijë Lekë / Person)	34,511	871		403

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Numri i personave me aftësi të kufizuara të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale për personat PAK	8	8	8	9
Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti	2,756	2,700		2,750
Numri i shërbimeve të ofruara për PAK-të në shtëpi-familje	5	5		5

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Shpenzime totale për qendrat rezidenciale PAK (në Mijë Lekë)	2,139			
Shpenzimet totale për mbështetjen e personave PAK (në Mijë Lekë)	276,090	6,967	329,712	333,885

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për mbështetje monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht ose plotësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), në masën 99% kundrejt planit 2020. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 26% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar mbështetjen për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar duke:

- Ofruar shërbime për persona të akomoduar në qendra shërbimesh
- Shërbyer një numri më të lartë personash qoftë si mbështetje monetare qoftë të shërbyer në shtëpi.

Kujdesi social për familjet dhe fëmijët



Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për familjet dhe fëmijët: korente dhe investime

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Kopshte dhe çerdhe funksionale	3	3	3	3
Çerdhe funksionale	1	1	1	1

Kopshte funksionale	2	2	2	2
Fëmijë të shërbyer në kopshte dhe çerdhe	70	85	220	85

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Shpenzimet për ushqim në qendrat sociale për fëmijë (në Mijë Lekë)	1,345	1,497	3,693	1,650

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për famijet dhe fëmijët në nevojë sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 93% kundrejt planit 2020. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 5% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar si edhe rritur mbështetjen për familjet dhe fëmijët në nevojë si :

- Familje dhe fëmijë në nevojë
- Fëmijë pa kujdes prindëror
- Fëmijë në qendra ditore
- Gra dhe fëmijë viktime të dhunës

Ndërkohë që për fëmijët e shërbyer në çerdhe dhe kopshte është ulur numri i tyre si rrjedhojë edhe e situatës pandemike ku prindërit janë frenuar në frekuentimin si më parë të këtyre institucioneve.

Realizimi faktik 2020

Vlera në mijë Lekë

Pesha ndaj totalit në %


Realizimi Faktik 2020



13%

90%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimit bazë përfshirë arsimin parashkollor: korente dhe investime

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës

Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)

Fakti 2018

Fakti 2019

Fakti 2020

Plan 2020

82

81

100

81

Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)

7

13

13

Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)

11

21

21

Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)

2,470

3,334

3,898

Produkte

Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë

Fakti 2018

Fakti 2019

Fakt 2020

Plani 2020

46

46

46

46

Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)

149

147

147

147

Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor

60

63

63

63

Të dhëna

Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç

Fakti 2018

Fakti 2019

Fakt 2020

Plani 2020

1,136

1,119

1,132

1,130

Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)

229

232

232

232

Mësues në sistemin parashkollor

68

68

68

73

Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç

1,380

1,376

1,132

1,390

Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	1,647	3,078		3,099
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë në Mijë lekë	113,623	153,357	163,128	179,303

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 90% të planit 2020. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020, ndërkohë që investimet e kryera përgjatë vitit 2020 bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 13% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2020 tregon se:

- Është rritur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- Është ruajtur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues edhe pse numri i nxënësve që frekuentojnë këtë sistem arsimor është rritur, nëpërmjet rritjes së numrit të mësuesve.
- Është rritur kostoja e një institucioni arsimor duke refketuar kështu ato pak investime të shtuara për këtë shërbim
- Investimet e realizuara përgjatë viteve synojnë përmirësimin e kushteve të punës së mësuesve dhe nxënësve. Investimet u realizuan në masën 94% të planit.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	14,406	45,771	60,307	64,080	94%
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje dyer te brendshme shkolla I.Muca			764	764	100%
Riparime te pjeseshme ne godinat arsimore	0	924	3,752	4,000	94%
Riparime te pjesshme ne godinat arsimore ne shkolla			878	878	100%

Rrjeti rrugor rural

Realizimi	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
------------------	---------------------------	--------------------------------	------------------------------


faktik 2020



7%

64%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor.

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

Trendi

Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
Aksidente të mjete (Ndryshimi vjetor në numër)		0	0	0
Aksidente të këmbësorëve (ndryshimi vjetor në numër)		0	0	0
Numri aksidenteve rrugore (ndryshimi vjetor në numër)		0		0
Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në %)		9		0
Rrugë rurale (rrjeti rural ndryshimi vjetor në %)		9		0
Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)		-100		0
Rrugë rurale të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)		-15		0
Rrugë urbane (rrjeti urban ndryshimi vjetor në %)		0		0
Rrugë urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)		-85		0
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane	393,380	135,225		151,890

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 64% të planit 2020 në një vlerë prej mbi 194 milionë

Lekë ku investimet përfaqësojnë rreth 39% të tyre. Bashkia shpenzon rreth 7% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi i cili tregon se:


- Mirëmbajtja e rrjetit rrugor ka mënjanuar aksidentet rrugore;
- Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural i bashkisë
- Është ulur (pothuajse përgjysmuar) kosto mesatare e 1 km linear rrugë të mirëmbajtur, duke përmirësuar kështu eficiencën e përdorimit të parasë publike.


Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Km rrugë të mirëmbajtura në vit nga të cilat:	410	310		310
- Rrugë rurale të mirëmbajtura	285	270		270
- Rrugë urbane të mirëmbajtura	125	40		40
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit	108	108		113
- Rrugë rurale të asfaltuara / shtruara	40	40		45
- Rrugë urbane të asfaltuara / shtruara	68	68		68

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	842	851		851
Rrjeti rrugor rural	729	738		738
Rrjeti rrugor urban	113	113		113
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në Mijë Lekë:	331,226	115,076		129,258

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Rrjeti rrugor rural	260,061	73,700	58,124	104,993	55%
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Kolaudues objekti "Rikonstruksion i rrugës automobilistike të fshatit Dardhë"	0	167			
Ndertim ure te Beli mbi lumin Shkumbin per Lagjen "Rrethi i Bardhe " Njesia Hotolisht	0	4,000			
Ndertim ure tip Beli mbi lumin Shkumbin rrethi i Bardhe, Nj.Hotolisht			4,236	4,236	100%
Ndertim vepra rrugore dhe ujore ne njesite administrative te Bashkise Librazhd			7,007	7,007	100%
Ndertimi i ures se lagjes Liqejthi Babje , ura ne rrugen Prevall-Dranovice , Ura dhe rik.i rruges se lagjes Llange, Ndertim ure Drapata, Ndertim ura e Galanonit	1,763				
Perforcimi i kembeve dhe mureve mbeshtetese te ures dranovic-Kostenje	1,410				
Rikonstruksion me asfaltobeton i rrugeve te demtuara ne qytet dhe njesite administrative			7,315	7,315	100%
Rikualifikimi urban Blloku i banimit Nr.1	56,914				
Shtese fondi: Rikonstruksion i rruges se fshatit			2,010	2,010	100%

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020		4%	82%



Qëllimi i programit buxhetor

Mbështetja e prodhimit bujqësor dhe aktivitetit të fermerëve nëpërmjet menaxhimit të infrastrukturës sekondare dhe terciare të kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↑	Kilometra linear kanal ujitës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (Raporti në %)			56.0	
↓	Kosto mesatare për 1 km linear kanal ujitës dhe kullues të menaxhuar (Buxheti i shpenzuar për ujitje dhe kullim kundrejt kilometrave total te sistemit ujitës dhe kullues Mijë lekë/për km)	295.8	261.0	290.4	148.0
↑	Numri i familjeve përfituese të shërbimit të vaditjes dhe kullimit (Ndryshimi vjetor		60.0	30.0	0.0

	në numër)				
→	Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim (Ndryshimi vjetor në ha)		3.0	0.0	2.0
→	Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje (Ndryshimi vjetor në ha)		0.0	0.0	0.0
↓	Sipërfaqja e tokës bujqësore e kultivuar kundërjet totalit të tokës bujqësore (Raporti në %)	83.3	89.1	43.6	89.1

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Familje përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit	4,710	4,770	4,800	4,770
Kanal kullues i pastruar në km linear	1	1		1
Kanal ujitës i pastruar në km linear	148	174	180	174
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim në ha	27	30	30	32
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje në ha	4,300	4,300	4,300	4,300

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Buxheti i shpenzuar për ujitje dhe kullim (në Mijë Lekë)	44,010	45,771	52,265	25,959
Sipërfaqe e tokës bujqësore (fondi bujqësor sipas Inventarit) në ha	4,600	4,600	9,631	4,600
Sipërfaqe e tokës së kultivuar në ha	3,830	4,100	4,200	4,100
Sistemi kullues në km linear			4	
Sistemi ujitës në km linear			320	

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin dhe organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, nën përgjegjësinë e bashkinë në të gjitha njësitet administrative të saj në masën 82%. Bashkia shpenzon rreth 4% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Me investime të rëndësishme të përvitshme nga buxheti i bashkisë performanca e këtij shërbimi tregon se:


- Janë bërë funksionale kanalet kulluese dhe vaditëse dhe po vazhdon pastrimi i mëtejshëm i tyre
- Ruajen e sipërfaqes bujqësore të mbuluar me shërbimin e vaditjes dhe kullimit
- Rritjen e numrit të familieve që përfitojnë shërbimin e menaxhimit të sistemit vaditës dhe kullues i cili mundëson që sipërfaqja e bujqësore në zotërim të tyre të mund të kultivohet dhe të rrisin prodhimet bujqësore
- Është rritur kostoja e pastrimit të një kilometri linear kanal kullues dhe vaditës (e cila reflekton kryesisht prezencën e investimeve në këtë sektor nga ana e bashkisë).

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	35,836	42,857	50,477	61,625	82%

Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje tuba e plasmas per kanalet vaditese			2,979	2,979	100%
Blerje tuba emergjente ne kanalet vaditese te demtuara			746	746	100%
Ndertim I rrjetit shperndares te ujesjellesit te fshatrave Dorez,Gizavesh,Librazhd Katund dhe I.Qender F.dyte	75,145				
Ndertim Rruge Orenje-Librazhd ,Loti II-te "	67,769				
Punime per transportin e tubave dhe ndertimin e sifonit te kanalit te ujitjes ,lagja Alla Shpata ,fshati Zgosht		800			
Rehabilitim urban I zones perreth fushes se sportit , Librazhd	6,822	3,827			
Rikonstruksion I kanaleve vaditese viti 2019 (Rikonstruksion kanali I Malit Hotolisht loti 1, Kanali Lunik Zdranshe Verri loti II			7,345	746	100%
Rikonstruksion I Rrugeve Rurale viti 2017	4,138	0			
Riparim lere betoni e plasmasi ekonomia pyjore ,Polis fshati Gurshpate , ekonomia pyjore Dardhe - xhyre , ekonomia pyjore fshati Vilan Polis	0	2,482	2,282	2,282	100%
Riparime te pjesshme emergjente ne kanalet vaditese			837	837	100%
Riparime te pjesshme ne kanale vaditese te Njesove Administrative			1,877	1,877	100%
V. Mbikqyrje - kolaudim te projekteve te zbatimit 2018	1,382	1,918			

Shërbime publike vendore

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
		3%	78%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj qoftë në qytet apo njësitë administrative.

Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Shërbime publike vendore: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
○	Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)	0.0	0.0		0.0
↑	Rrënjë pemë dekorative (fondi i pemëve në hapësirat e gjelbërta (Ndryshimi vjetor në numër)		114	16	70
○	Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore (në %)	2.5	1.3		1.4
→	Trotuare (Ndryshimi vjetor në km linear)		0.0	0.0	0.0

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Rrënjë pemë të mbjella në vit	120	234	250	304
Sipërfaqe e gjelbëruar në vit në Km katrorë		0		0

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fondi total i pemëve dekorative / gjelbëruese të bashkisë	2,836	3,070	3,320	3,374
Sipërfaqe totale e bashkisë në km katrorë	793	793	793	793
Sipërfaqe totale e gjelbër publike në Km2	0	0		0
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit (në mijë lekë)	1,459	1,267		1,320
Të ardhurat nga tarifat vendore (në mijë lekë)	59,377	100,743	86,329	94,451

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime të cilat përfshijnë gjelbërimin e hapësirave publike, shtimin dhe përmirësimin e trotuareve, mirëmbajtjen e varrezave publike në masën 78% të planit 2020. Bashkia shpenzon për këtë shërbim rreth 3% të buxhetit të saj. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- Është shtuar fondi i pemëve dhe bimëve dekoruese të ambjenteve publike të gjelbëruara nga bashkia
- Është shtuar numri i pemëve dhe bimëve dekorative të mbjella gjatë vitit 2020 duke

përmirësuar cilësinë e hapësirave të gjelbërta publike, si të paktat mundësi rikrijuese në bashki.

Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë në përgjithësi për ekonominë e vendit dhe të bashkisë, bashkia për të lehtësuar barrën fiskale të qytetarëve dhe bizneseve ka falur pagesën e tarifave vendore për pjesën e parë të vitit. Për rrjedhojë edhe të tarifave të gjelbërimit. Në planin e saj bashkia synon që prej përmirësimit të të ardhurave nga tarifa e këtij shërbimi do të mund të mbulohet totalisht kostoja e këtij shërbimi nga tarifat e më tej të japë mundësinë për hartimin e projekteve konkrete për shtimin e hapësirave të gjelbërta të bashkisë dhe rrjetin e trotuareve.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Shërbime publike vendore	4,632	598	839	1,120	75%